



Përgjigjet e Bashkive gjatë Covid-19

Të gjitha bashkive të vendit ju desh të përdornin mënyra të reja gjatë javëve sfiduese të pandemisë virusit të ri respirator. Distanca kohore dhe informacioni i grumbulluar nga disa burime na jep një perspektivë më të plotë për arritjet, mangësitë dhe dështimet e identifikuar nga aktorë të qeverisjes qendrore dhe asaj vendore. Ky raport përfundimtar ka si qëllim të listojë në formë përmbledhëse aktivitetin e bashkive në përballimin e situatës si dhe aktorëve të tjerë që kontribuuan në menaxhimin e situatës. Njësitë të vetëqeverisjes vendore ju desh të angazhoheshin me shpejtësi dhe të adaptoheshin me nevojat në ofrimin e shërbimeve ekstra të pa parashikuara, si dezinfektimi, raportimi dhe monitorimi i dhunës në familje apo ofrimin e shërbimit psiko-social. Krahas këtyre shërbimeve u vu re një trend pozitiv në përdorimin e hapësirës digjitale për ofrimin e shërbimeve si trajtimi i ankesave etj. apo raportimet me formularë online.

Bashkëpunimi e institucioneve të Qeverisë Qëndrore në nivel lokal dhe qeverisjes vendore

Pas infektimit të para, në dt 17 Mars pasi numri arriti 40 të infektuar (**38 në Tiranë & 2 në Rrogozhinë**) në Ministrinë e Mbrojtjes u ngrit menjëherë Komisioni Ndërmintor i Emergjencave, i cili në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Brendshme, orientoi strukturat e emergjencave vendore dhe lokale. Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236 datë 19.03.2020 "Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19" Prefektët e Qarqeve nxorën urdhrat "Për ngritjen e shtabeve koordinuese në nivel qarku" hartuan planet e veprimit dhe i dërguan për njohje dhe zbatim bashkive dhe institucioneve pjesë të këtij shtabi. Si pasojë të vendimit të Këshillit të ministrave u mbyllën të gjitha institucionet arsimore publike dhe jo-publike, si dhe u paralajmëruan masa administrative. Drejtoritë vendore të policisë dhe bashkitë, nëpërmjet atyre që u quajtën "patronazhistë", kontaktuan me telefon të gjithë shtetasit shqiptarë dhe të huaj që rezultuan që kishin hyrë në Shqipëri nga zona të kuqe sipas territoreve të komisariateve, me telefon dhe fizikisht. U anuluan të gjitha aktivitetet ku kishte grumbullime të mëdha me njerëz si aktivitetet: sportive, kulturore, koncertet, konferencat etj.

Institucioni I prefektit në të 12 qarqet koordinoi punën e bashkive për marrjen e masave dhe dhënien e asistencës për personat e moshës së tretë në nevojë duke kërkuar; 1) identifikimin e të moshuarve të jetojnë vetëm; 2) Numri i të moshuarve me të cilët është kontaktuar; 3. Numrin e të moshuarve që janë ndihmuar; 4. Si është menduar dhënia e ndihmës në ditët në vijim. Krahas këtij informacioni u kërkua informacion i zgjeruar për: 1) familjet që jetonin në çadra për shkak të humbjes së banesës nga tërmeti; 2) personat me aftësi të kufizuara; 3) të asistuarit me ndihmë ekonomike, etj.

Në zbatimin e udhëzimeve të Grupit Ndërmistror të Emergjencës krahas bashkive u koordinuan institucione si: Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor, Drejtoria Rajonale e Agjencisë Kombëtare të Ushqimit, Inspektoriati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Inspektoriati Shtetëror i Punës, Drejtoritë Vendore të Policisë etj.

Bashkitë edhe pse herë herë jashtë ushtrimit të funksionit të tyre, asistuan policinë e shtetit dhe organet qendrore në menaxhimin e situatës shëndetësore (kryesisht në nivel të rendit publik apo distancave sociale).

Shoqatat e Bashkive

Shoqatat e bashkive u pozicionuan menjëherë në ofrimin e asistencës së tyre në funksion të menaxhimit të situatës, duke evidentuar nevoja specifike nga ana e pushtetit vendor si dhe duke ofruar opsione zgjidhjeje. Në këtë drejtim Shoqata për Autonomi Vendore (SHAV) u angazhua për të përmirësuar dhe rritur komunikimin mes pushtetit vendor dhe qeverisë në adresim të situatës duke krijuar një grup interaktiv online. Linja e komunikimit ofroi informacion në kohë reale dhe mundësoi pranimin e sugjerimeve paraqitur Ministria e Financës dhe Ekonomisë, mbi rishikimin e kalendarit buxhetor 2020 dhe procesit publik të diskutimi të buxhetit me pjesëmarrje. Shoqata e Bashkive të Shqipërisë nga ana e saj nisi një fushatë komunikimi në mediat kombëtare duke listuar zgjidhje të mundëshme për pushtetin vendor, duke i adresuar këto sugjerime ndaj Qeverisë Qendrore. SHAV u angazhua gjithashtu në një studim mbi Mbrojtjen Civile në nivel vendor. Krahas këtij studimi në 21 Maj 2020 u organizua një takim online midis Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, dhe prefekteve të disa qarqeve¹, përgjegjës për emergjencat civile nga institucioni i prefektit të Qarkut Lezhë, si dhe ekspertëve të projektit Bashki të Forta. Qëllimi i takimit më Prefektët e Qarkut ishte marrja e mendimeve mbi masat që duhet të ndërmarrin bashkitë lidhur me mbrojtjen civile, dobësitë, sfidat dhe problemet, si dhe rekomandime nga këndvështrimi i institucionit të prefektit por edhe bazuar në eksperiencat e situatave të emergjencës , në të cilat prefekti i qarkut ka rol kryesor për koordinimin e institucioneve të ndryshme në nivel qarku.

Edhe pse rreth 89% e bashkive kanë ngritur strukturat për mbrojtjen civile si pjesë e organigramës së bashkisë, u theksua nevoja për rishikim të kriterëve të punësimit të specialistëve të mbrojtjes civile, rekomandimi që strukturat të jenë në varësi të drejtpërdrejtë nga kryetari i bashkisë.

Çfarë funksionoi?


Në tërësi u vu re një bashkëpunim i mirë midis pushtetit qendror dhe atij vendor në implementimin e nevojave më të menjëhershme për shtresat në nevojë

Ndihma për familjet në nevojë dhe për pensionistët në nevojë ishte fokusi kryesor në ditët e para të pandemisë, ku bashkitë u mobilizuan gjerësisht për të asistuar këto shtresa shoqërore. 233,248 ishte numri i familjeve që morën asistencë ushqimore dhe jo ushqimore. Siç shihet dhe në grafikun me të dhënat e mbledhura nga Ministria e Brendshme², ishte bashkia Tiranë, Elbasan dhe Korçë të cilat kanë asistuar më shumë familje gjatë kësaj periudhe

¹ Prefekti i Qarkut Durrës, Prefekti i Qarkut Berat, , Prefekti i Qarkut Dibër, Prefekti i Qarkut Elbasan, Prefekti i Qarkut Korçë,

² Të dhëna të vëna në dispozicion nga Drejtoria për Çështjet Vendore dhe Prefekturat pranë Ministrisë së Brendshme

Transmetimi i mbledhjeve online nga një numër bashkish tregon për një tendencë pozitive për transparencë nga këshillat bashkiak paçka se kjo nuk është një qasje e njëjtë në të gjitha bashkitë. 4 Bashki kanë mbajtur dhe transmetuar vetë ose nëpër medias lokale mbledhjet e këshillit, dhe 14 janë asistuar drejtpërdrejtë nga bashki të forta në aspekte të teknologjisë. Në rastin e mbledhjes së këshillit bashkiak Durrës, këshilltarët i kërkuan administratës të regjistrojë pyetjet e qytetarëve dhe t'i jepte përgjigje pyetjeve të tyre.





Pas ngritjes së Grupit Ndër Institucional i Punës për ofrim asistencë për shtresat në nevojë, AMVV ka koordinuar dhe mbledhur raportime për asistencën që po shpërndahej në terren. Ky raportim nëpërmjet formularëve online, filloi në datë 1 në Tiranë, në 8 Prill në Korçë dhe 9 Prill në të gjitha bashkitë e vendit. Kjo ishte një praktikë e re për disa bashki të cilat varionin në shpeshtësinë e raportimeve për llojin e asistencës që ato ofronin dhe ofronin të dhëna të përditësuara.

Sipas Raportit Kumulativ të ofruar nga AMVV³ numri total i familjeve të asistuar⁴ për shërbime apo të ndihmuara me pako ushqimore deri më datë 29 Maj 2020 ishte 73,287 familje dhe 196,225 persona. Pjesa më e madhe e asistencës është dhënë në qarkun e Tiranës me 21.6% ndjekur nga qarku i Beratit me 10.2% ndërkohë që nivelet më të ulëta janë shënuar në qarqet e Durrësit me 3.1% dhe Kukësit me 5.0%.

³ Raportim Kumulativ mbi Zbatimin në Terren të Asistencës Sociale për periudhën deri në 29 Maj 2020

⁴ Në raport shprehet se familjet mund të jenë ndihmuar më shumë se një here. Gjithashtu raporti shpjegon se numri i personave nuk është i dhënë për çdo familje në rastin e bashkisë së Tiranës dhe Shkodrës duke që se raportimi për këto bashki nuk është bërë me të njëjtin sistem.

Përpjesa e raportimeve sipas qarqeve



Përgjithësisht, asistencë e dhënë për familjet ka qënë e shpërndarë si në shërbime edhe për ndarje pakosh ushqimore. Në nivel vendi 31.2% ose 22,878 e shërbimeve kanë qënë për asistencë, 67.6% ose 49,560 familje në ndarje pakosh ushqimore dhe 1.2% ose 849 familje në ndarje pakosh ushqimore dhe asistencë. Gjatë periudhës 8 Prill - 29 Maj, ka qënë Bashkia e Gjirokastrës e cila ka raportuar nivelin më të lartë të ditëve me 44 ditë, ndjekur nga bashkia Tiranë dhe Korçë me 32 ditë të raportuara.⁵

Gjatë periudhës së pandemisë disa organizata të shoqërisë civile monitoruan aspekte të asistencës sociale dhe ndihmës në 8 bashki të vendit duke prodhuar një raport përmbledhës. Informacioni bazohej kryesisht nga vendimet e këshillave bashkiak, monitorimi i medias dhe intervista me qytetarë për të vlerësuar perceptimin e tyre. Krahas tyre gjatë kësaj periudhe Shoqata e Bashkive publikuan një vëzhgim studimor mbi mbrojtjen civile dhe Co-Plan nxorri studimin mbi aftësitë ripërtëritëse të njësive të vetëqeverisjeve vendore në rastet e rreziqeve dhe fatkeqësive natyrore.⁶

⁵ [Hiperlink për dokumentin dhe hartat e AMVV](#)

⁶ <http://www.co-plan.org/building-resilience-for-local-governments-in-albania-legal-and-institutional-challenges/>

Mundësi të reja nga digjitalizimi në kohën e Covid-19

Informimi: Paçka se masat shtrënguese të Covid-19 impact mënyrën e ushtrimit të funksionimit të bashkive, përdorimi i mjeteve të teknologjisë së informacionit mundësoi hedhjen e disa hapave të rëndësishëm në afrimin e institucionit të bashkisë me qytetarët. Bashkitë përdorën më së shumti median sociale facebook (61 Bashki) dhe pjesërisht websitet e tyre dhe median lokale për të informuar mbi masat që po merreshin për të administruar situatën. Bashki si Shkodra raportuan në format më të detajuar ditë për ditë mbi aktivitetin e tyre gjatë COVID-19. 7 Bashki⁷ kanë transmetuar drejtpërdrejt në Facebook, mbledhjet e këshillit ku është prezantuar dhe diskutuar mbi Raportin e Performancës për 2019. Krahas transmetimit këto këshilla bashkiak kanë lançuar një sondazh online për qytetarët, në mënyrë që ata të shprehen mbi dobishmërinë e raportit dhe performancën bashkiake. **Vendimmarrja:** Këshillat bashkiakë arritën të ushtrojnë funksionin e tyre vendimmarrës falë teknologjisë. Kombinimi i Aktit Normativ të QQ 15.03.2020, rregulloreve të reja për funksionimin e këshillave, udhëzuesi i përgatitur nga Bashki të Forta dhe asistencë e vazhdueshme teknike bënë që jo vetëm të mundësohej zhvillimi i mbledhjeve të këshillit, por gjithashtu dhe transmetimi drejtpërdrejtë në media lokale (Shkodër, Fier, Kukës) dhe median sociale Facebook (11 bashki). **Pjesëmarrja:** Në Elbasan administrata bashkiake dhe këshilli bashkiak në 12 Maj zhvilluan një diskutim live në Zoom me studentë të fakultetit Ekonomik të Elbasanit mbi Raportin e Performancës 2019. Ky diskutim u transmetua live në faqen e FB të Kryetarit të Bashkisë dhe Bashkisë, i cili mori dhe disa pyetje drejtpërdrejtë nga qytetarët që po e ndiqnin diskutimin në këtë platformë. Transmetimi i drejtpërdrejtë në media sociale ka mundësuar mbi 100 komente nga qytetarët për administratën bashkiake apo për këshillin bashkiak. **Monitorim:** Administrata bashkiake përdori teknologjinë për monitorim të shpërndarjes së ndihmës në fazën e parë të emergjencës (pilotuar fillimisht në Korçë) e më pas kudo. Në javën e dytë të majit ka nisur përgatitja për monitorimin e zbatueshmërisë të masave nga bizneset dhe shkollat të cilat do të rifillojnë aktivitetin në dt. 18 Maj. Ky monitorim do të bëhet nëpërmjet një formulari online i cili do plotësohet nga një taskforcë e përbërë nga Inspektoriati shtetëror shëndetësor, Agjencia Kombëtare e Ushqimit, Inspektoriati I Punës, Policia dhe koordinuar nga prefekti. (ISHSH, AKU, Inspekt punes, Dr tatimore, Policia). Task forca koordinohet nga Institucioni i Prefektit.

ISHSH, AKU, Pretë ngarkuara me ligj për monitorimin e protokolleve të sigurisë bashkive i është vënë në dispozicion një instrument raportimi live mbi zbatueshmërinë e masave në terren.

E-services dhe ankesat: Pengimi i lëvizjeve gjatë pandemisë krijoi nevojë që bashkitë të vënë në dispozicion mundësi të reja për ofrimin e disa shërbimeve. Në Berat qytetarët inkurajoheshin të depozitonin ankesat nëpërmjet email-eve. Në Tiranë dhe Kukës qytetarët mund të komunikojnë në numrat e gjelbër në Whastapp për çdo nevojë apo nëse dëshironin të kontribuonin si vullnetarë.

Çfarë mund të përmirësohet?

Ajo që u vu re ishte koordinimi i mirë i strukturave vendore me njëra tjetrën paqartësi dhe vonesa të shpeshta në përcjelljen e informacionit lidhur me vendimet e marra dhe orjentimin për zbatimin e tyre nga niveli qendror, ministritë. Gjithashtu, ndryshimi i herë pas herëshëm i formatit të raportimeve për shpërndarjen e ndihmave dhe asistencës solli konfuzion, lodhje dhe acarim të strukturave lokale dhe veshtiresi në grumbullimin, përpunimin e informacionit. Kontratat e hoteleve për njëzëritë që duhet të karantinoreshin në zonat kufitare u lidhën shumë me vonë se dalja e vendimit nga Ministria dhe nuk u koordinua mirë me prefektet e qarqeve me gjithë insitimin e vazhdueshëm të tyre, kjo solli probleme me shtetasit sidomos në Qarkun Shkoder, Gjirokaster dhe Korçë. Gjate kesaj periudhe dhe sidomos ne fillimet e saj shpesh here kane dale urdhra dhe udhezime ne

⁷ Mbledhjet e transmetuara live mund të ndiqen në faqet e Facebook të bashkive Elbasan, Kukës, Bulqizë, Mat, Dropull, Tepelenë, Maliq

funksion te menaxhimit sa me mire te situates, por ne disa raste keto akte kane qene jo te plota dhe te paqarta duke mos percaktuar qarte detyrat e institucioneve apo te njesive vendore.

Gjatë kësaj periudhe dhe sidomos në fillimet e saj shpesh herë kanë dalë urdhëra dhe udhëzime në funksion të menaxhimit sa më mirë të situates, por në disa raste këto akte kanë qënë jo të plota dhe të paqarta duke mos përcaktuar qartë detyrat e institucioneve apo të njesive vendore.⁸

Kontratat e hoteleve për njerëzit që duhet të karantinoeshin në zonat kufitare u lidhën shumë me vonë se dalja e vendimit nga Ministria dhe nuk u koordinua mirë me prefektet e qarqeve me gjithë insitimin e vazhdueshëm të tyre, kjo solli probleme me shtetasit sidomos ne Qarkun Shkodër, Gjirokastrë dhe Korçë.⁹

Institucioni I Prefektit të Qarkut hasi vështirësi në krijimin e Task Forcë për ngritjen e grupeve të inspektimit në terren për kontrollin e masave lehtësuese. Kjo ndodhi si rezultat I mungesës së një baze ligjore për ngritjen e kësaj task force në nivel vendor, por kishte vetëm nje email sqarues ku nuk përcaktohej qartë se si do të funksiononte dhe cili do të ishte roli i grupeve institucionale.

Çfarë mësuam?

U vu re se bashkitë mund të funksionojnë edhe në kohë krizash, ku funksioni i vendimmarrjes falë teknologjisë nuk çënohet (60 këshilla bashkiak mbajtën mbledhje online) por edhe ka hapsirë për të ofruar transparencë më të rritur se më parë. Këshillat bashkiakë krahas vendimmarrjes treguan se mund të ushtrijnë pjesërisht funksionin e mbikëqyrjes për disa shërbime (shih, dhuna në familje apo shpërndarja e ndihmës tek familjet në nevojë).

Webinaret e organizuara nga ASPA ofruan një platformë shumë të vlefshme mbi "Roli i këshillave bashkiakë për nisma të buxhetuara gjinore", "Buxhetimi i Përgjigjshëm Rom në Nivel Vendor", "Roli i Pushtetit Vendor në Menaxhimin e Situatës COVID-19" mbi njohjen e perceptimeve të këshilltarëve në rastin e dhunës në familje, si dhe "Shërbimi psikologjik për fëmijët 3-6 vjeç gjatë Covid-19" etj.

U provua dhe njëherë që gratë këshilltare në komisionet e barazisë gjinore janë kyçe dhe pro aktive në vendimmarrjet demokratike, tregojnë pjesëmarrje aktive si dhe ushtrijnë aty ku lejohen rolin e tyre mbikëqyrës në këshillat bashkiak (45 nga 60 komisione të këshillave bashkiak firmosën rezolutën për dhunën në familje, dhe kërkojnë raportim periodik nga administrata bashkiake).

Ministria e brendshme ka identifikuar se një adresim i veçantë për të përballuar situatën duhet vënë tek: Krijimi i 12 qendrave vendore operationale të emergjencave, me burime njerëzore të mirëtrajnuara, buxhet të përshatshem dhe mjete operationale; Krijimi i një qendre funksionale të urgjencës shëndetësore publike e pajisur me personel dhe pajisje bashkohore të dhënies së ndihmës dhe reagimit; Forcimi i sistemeve shëndetësore; Prioritizimi i nevojave të shtetasve në nevojë; Akte te qarta me detyra konkrete; Reagim dhe ndërveprim më i shpejtë nga lartë poshtë; Kërkimi, mbledhja e informacionit nga një strukture dhe jo nga të gjitha ministrinë në drejtime të ndryshme, kanalizimi i komunikimit.

⁸ Burimi: Ministria e Brendshme

⁹ Po aty

Edhe pse nuk pati një inisjativë kombëtare si në vende të tjera për thirrje për vullnetarë, në nivel vendor disa bashki ¹⁰ bashkëpunuan suksesshëm duke ofruar asistencë specifike për të moshuarit dhe familjet në nevojë në blerjen dhe shpërndarjen e ushqimeve apo ilaçeve apo ndihmë me anë të telefonave jeshilë për mbledhje informacioni¹¹. Solidarizimi shoqëror u vu re edhe tek kontributet që bizneset lokale dhe ato kombëtare dhanë për shtresat në nevojë apo në zgjidhje të shpejta në infrastrukturë apo llogjistikë.

Efektet financiare

Gjatë periudhës së pandemisë bashkitë i fokusuan përpjekjet dhe buxhetet e tyre në përgjigje të situatës së pazakontë. Kjo përgjigje u shtjellua në disa aspekte.

Së pari bashkitë aktivizuan fondin e emergjencës prej 4% për t'ju përgjigjur situatës dhe kryer dezinfektimet dhe mbështetur familjet në nevojë me pako ushqimore. Përtej aktivizimit të këtij fondi një pjesë e mirë e bashkive kryen rialokime buxhetore duke pakësuar fondet për infrastrukturën, ujësjellës kanalizime apo shërbime publike vendore drejt aktiviteteve të emergjencës, së sipër përmendura. Sipas observimit të kryer nga Bashki të Forta, në 26 bashki të vendit, këshillat bashkiakë kanë rialokuar rreth 140 mln LEK nëpërmjet vendimeve të tyre. Rreth 15 bashki kanë kërkuar asistencë të dedikuar për të përmirësuar formulimin e vendimeve bashkiake, të cilave u janë ofruar modele transparente me informacion të zgjeruar mbi rezultatet dhe kostot sipas kërkesave të legjislativës për formulimin e vendimeve dhe asistencë e dedikuar.

Një tjetër aspekt i përgjigjes nga bashkitë ka qënë ai i lehtësimit të barrës fiskale. Rreth 1/3 e bashkive (20) kanë ndërmarrë ndryshime lehtësuese¹². Ato variojnë nga shtyrja e afateve të pagesave të taksave dhe tarifave deri në faljen e tyre për një periudhë të caktuar (3 deri në 5 muaj). Nga 17 bashki të observuara nga afër efekti financiar i ndryshimit është rreth 300 mln LEK , ku 80% i dedikohet ndryshimeve në tarifa dhe 20% ndryshimeve në taksa. Tarifat e shërbimit dhe taksa e ndërtimit janë ato më të afektuarat. Këto ndryshime kanë pasur përfitues familjet bizneset dhe në disa raste në menyrë të dedikuar shtresat në nevojë ose personat PAK

Si pasojë e mbylljes të aktivitetit ekonomik dhe ndryshimeve në paketën fiskale të ardhurat e bashkive pritet të zvogëlohen ndjeshëm¹³. Bashkitë i janë përgjigjur kësaj situatë duke parashikuar rishikime buxhetore në periudhën Qershor -Korrik. 22 bashki kanë konfirmuar rishikimin e buxhetit 2020. Këto ndryshime janë hapi i parë drejt një planifikimi të matur për periudhën 2021-2023 nëpërmjet procesit të Projekt Buxhetit Afatmesëm.

Roli i Qeverisë Qëndrore përgjatë kësaj faze ka qënë vendimtar për të udhëzuar bashkitë nëpërmjet udhëzimeve për prioritarizimin e shpenzimeve si dhe ngadalësimin e procesit të planifikimit që pritet të rimerret me lehtësimin e masave.

¹⁰ Shih raportet e hartuara nga Bashki të Forta për COVID-19 për bashkitë që përdorën vullnetarët për forma të ndryshme asistence <http://bashkiteforta.al/raporte-javore-covid-19/>

¹¹ Referoju raporteve tek <http://bashkiteforta.al/raporte-javore-covid-19/>

¹² Shih raportin <http://bashkiteforta.al/wp-content/uploads/2020/05/Raporti-Javor-28Prill-4Maj.pdf>

¹³ https://www.monitor.al/covid-19-shpartallon-buxhetin-te-ardhurat-bien-30-ne-prill-132-milione-euro-me-pak-per-4-mujorin/?fbclid=IwAR29gUJIGbOchSndYCGM9P7uPoMFpoxynY-i-Chon6iHY_YeTUQpo7q9FD0

Shërbimet e mbështetura nga Bashki të Forta gjatë Covid-19

Shërbimi Psikosocial

Situata e Covid-19 krijoi kushte të favorshme për njohjen e rëndësisë së shërbimit të psikologut në arsimin parashkollor. Falë një angazhimi të suksesshëm midis Zyrave Arsimore për Arsimin Para universitar, Drejtorive të arsimit parashkollor u zhvilluan një seri me webinare dhe video konferenca për ofrimin e shërbimit për qytetarët. Ekspertët e fushës vendosën theksin tek nevoja për formimin e një skeme të qëndrueshme të trekëndëshit (prind, edukator, psikolog). Bashki të Forta mbështeti këto aktivitete dhe shembulli i suksesshëm në qytetin e Durrësit, për një platformë referimi për prindërit dha shkas që edhe bashki të tjera të zhvillonin aktivitet informues si dhe të ofronin shërbim.

Bashki të Forta zhvilloi një sërë me webinare ku prindërit, edukatorët dhe psikologët u shprehën mbi nevojën për një koordinim më të mirë midis prindit, edukatorëve dhe psikologëve. Në fakt 80% e prindërve dhe 70% e edukatorëve të pyetur vlerësojnë rolin e psikologut në kopshte si të domosdoshëm, 10% shprehen se psikologu nevojitet në raste të caktuara dhe vetëm 10% e shohin atë si të parëndësishëm. Prindërit (80%) dhe edukatorët (80%) e pyetur gjithashtu u shprehen se mendojnë se është mungesa e fondeve e cila është shkak për mungesën në kopshte, dhe vetëm 20% shihnin nivelin e profesional si arsye të mungesës që tyre në kopshte. Nga ana e tyre psikologët e pyetur po ashtu e shihnin rolin e tyre të domosdoshëm sidomos në kthimin e fëmijëve në kopshte (50%), dhe 50% e shihnin si pjesë integrale të kopshtit rolin e tyre.


Kjo nisëm konkludoi me ofrimin e një udhëzuesi për mënyrën se si duhet zbutur tranzicioni i fëmijëve nga karantina në rutinën e përditshme, i cili u shpërnda nga Ministria e Arsimit tek të gjitha kopshtet me rastin e hapjes se tyre më 1 qeshor.

Dhuna në familje


Bashki të Forta u informua se shifrat e raportuara nga qendrat e mbrojtjes ndaj dhunës të menaxhuara nga shoqëria civile nuk korrespondojnë me ato të ofruara nga policia. Në fakt shifrat e këtyre qendrave tregonin për një numër më të lartë krahasuar me një vit më parë, kur ato që ofron policia ishin më ultra edhe se një vit më parë. Gjithashtu gjatë Webinareve me anëtarë të komisioneve të barazisë gjinore u vu re se vetëm 38% e pjesëmarrësve kishin dijeni për dhunën në familje që ndodhte në komunitetet e tyre dhe vetëm 14% e këtyre pjesëmarrësve kishin dijeni për mekanizmat të cilat bashkia ka në dispozicion për të lehtësuar dhunën. Bashki të Forta ofroi ndihmë në hartimin e një rezolute tip për monitorimin dhe raportimin e situatës së dhunës. 45 komisione nga 60 e miratuan dhe po veprojnë në menaxhimin e situatës. Covid-19 kështu prodhoi kushte dhe mundësi për rritjen e njohurisë të kapaciteteve të komisioneve gjinore mbi rolin e tyre mbikëqyrës (më së shumti në fushën e dhunës në familje).

Nga sistemi i raportimit në këshillat bashkiakë, janë 167 raste të identifikuara të dhunës në familje në kuadër të rezolutës të miratuar. Raportimi i koordinatorit të dhunës në familje është periodik dhe ofron informacion pranë këshillit për rastet e identifikuar. Viktimat kryesisht kanë qënë gra (përfshirë edhe trafikimin njerëzor), por gjithashtu fëmijë dhe të moshuar (shih grafikun më poshtë).

Njësi të vetëqeverisjes vendrore të cilat kanë raportuar raste të dhunës



Shërbim i ofruar për viktimat e dhunës gjatë COVID 19



Dezinfektimi

Dezinfektimi i ambienteve dhe hapësirave publike ishte një nga masat shtesë që morën bashkitë për t’iu përgjigjur situatës së vështirë si pasojë e COVID-19. Për këtë bashkitë angazhuan burimet e tyre financiare dhe njerëzore për të bërë dezinfektimin e rrugëve, trotuareve, tregjeve, shesheve, objekteve si shkolla, kopshte, çerdhe apo hapësira publike të të përbashkëta. Vështirësive të prezantuara nga bashkitë në mungesë të eksperiencave të mëparshme me dezinfektimet e ambienteve publike qoftë në llogaritjen e kostove të nevojshme, apo për procedurat e prokurimit dhe organizimit të procesit të dezinfektimit, projekti Bashki të Forta iu përgjigj duke vënë në dispozicion të bashkive të interesuara një model të llogaritjes së kostove të dezinfektimit si dhe rekomandime përkatëse për procesin e prokurimit duke filluar nga përgatitja e një modeli për specifikimet teknike, rekomandime për çmime reference, norma dozimi dhe aplikimi në praktikë të dezinfektimit. Kjo paketë mbështetëse e bazuar në grumbullimin e përvojave pozitive nga bashkitë që e aplikuan dezinfektimin menjëherë pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme dhe akteve normative të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, u diskutua edhe me projektet e GIZ dhe Ministrinë e Turizimit dhe Mjedisit.

Me shkresën e saj të dt. 17.04.2020, Ministria e Turizimit dhe Mjedisit përcolli tek të gjitha bashkitë modelin e llogaritjes së kostove shtesë të dezinfektimit së bashku me rekomandimet përkatëse. Këto rekomandime kishin si qëllim të ndihmonin bashkitë në marrjen e masave efektive në zbatimin e aktit normativ të Këshillit të Ministrave për përballimin me lehtësi të situatës së krijuar si pasojë e COVID-19. Gjithashtu aplikimi i këtyre rekomandimeve do të ndihmonte në rritjen e transparencës në vendimarrjen e këshillave të bashkisë dhe komunikimin me taksapaguesit, duke lehtësuar jo vetëm punën e strukturave administrative të bashkisë, por edhe zbatimin e parimeve të qeverisjes së mirë dhe masave antikorruption.

15 Bashki e aplikuan menjëherë këtë model dhe rekomandimet e tij, ndërsa 8 bashki shprehën vullnetin në aplikimin e këtyre rekomandimeve shtesë, nëse do t’ju duhet të riblejnë përsëri materiale dezinfektuese.